



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.188/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në përbërje nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr 124/2014 të datës 05.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

I Miratohet si i bazuar apeli i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për rishqyrtimin e vendimit Anr 124/2014 të datës 06.06.2014.

II Ndryshohet vendimi i PZAP-it Anr 124/2014 të datës 06.06.2014, ashtu që subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 06.06.2014, Partia Demokratike e Kosovës, dega në Prishtinë, ka parashtruar apel ndaj vendimit të PZAP-it Anr 124/2014 të datës 05.06.2014 në të cilin kërkon nga PZAP-i që ta rishqyrtoj vendimin në fjalë pasi që për rastin në fjalë lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik LDK, subjektit politik PDK nuk iu është dhënë mundësia që konform nenit 120 të LZP-së që të ofrojë fakte apo përmisimin lidhur me shkeljet e pretenduara. Me këtë rast parashtruesi i apelit si dëshmi ka bashkangjitur vendimin Anr 124/2014 dhe fotografit me të cilën dëshmohet veprimi i ndërrmarjes së masave përmisuese gjegjësisht largimin e posterave nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj apelin gjeti se:

Apeli është i bazuar

Bazuar në Neni 118.4 i LZP-së parasheh që mund të apelohej vendimi i PZAP-it, sikurse PZAP-i, mund të rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Me këtë rast subjekti politik PDK në mbështetje të nenit 118.4 të LZP-së, ka bërë apel ndaj vendimit të PZAP-it duke i

ofruar prova të reja të cilat nuk kanë dhe dëshmi konkrete për evitimin e shkeljeve të bëra dhe duke i larguar menjëherë posterat nga vendi i palejuar ku kanë qenë të vendosura ato. Me këtë rast subjekti politik PDK ka bërë përpjekje dhe ka evituar shkeljen e bërë që PZAP-i mori si rrethanë lehtësuese dhe e cila ka ndikuar në ndryshimin gjorbës së shqiptuar me vendimin Anr 124 /2014 të datës që ka qenë 5100 (pesëmijë e njëqind) euro, dhe për këtë arsye gjoba i zbritet prej 5100 (pesëmijë e njëqind) euro deri në 2000 (dymijë) euro.

Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e lartcekura e poashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 dhe 118. paragrafi 4 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.188 /2014 më datën 06.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*